

L I G J
Nr. 8971, date 14.11.2002

PER DISA SHTESA NE LIGJIN NR. 8113, DATE 28.3.1996 "PER
DEKORATAT NE REPUBLIKEN E SHQIPERISE", NDRYSHUAR ME
LIGJIN NR. 8765, DATE 2.4.2001

Ne mbështetje te neneve 78, 81 pika 1 dhe 83 pika 1 te Kushtetutës, me
propozimin e
Këshillit te Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKES SE SHQIPERISE

V E N D O S I:

Ne ligjin nr. 8113, date 28.3.1996 "Për dekoratat ne Republikën e
Shqipërisë", ndryshuar me ligjin nr. 8765, date 2.4.2001, bëhen shtesa si
me poshtë:

Neni 1

Ne nenin 3 shtohet pika 12 me këtë përmbajtje:
"12. Medalja e Mirënjohjes".

Neni 2

Pas nenit 14/1 shtohet neni 14/2 me këtë përmbajtje:

"Neni 14/2
Medalja e Mirënjohjes

Kjo medalje u jepet qytetareve shqiptare ose te huaj, ne raste festash
zyrtare dhe ngjarjesh historike. Medalja te jete e arte."

Neni 3

Ky ligj hyn ne fuqi 15 dite pas botimit ne Fletoren Zyrtare

Shpallur me dekretin nr. 3566, date 19.11.2002 te Presidentit te
Republikës se Shqipërisë, Alfred Moisiu

